



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, sipas autorizimeve të përcaktuara me nenin 63.4 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë dhe me nenin 3, paragrafi 4 të Rregullës së KQZ nr. 01/2023 mbi Regjistrimin dhe Funksonimin e Partive Politike, me datë 06.12.2023 duke votuar me procedurën qarkulluese merr këtë:

V E N D I M

Për regjistrimin e partisë politike Srpska Demokratija-SD

- I. Regjistrohet partia politike “Srpska Demokratija” me akronim SD, me Kryetar z. Aleksandar Arsenijević.
- II. Partia politike Srpska Demokratija, i ka përmbushur të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 13 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe obligimet e përcaktuara me nenin 2 të Rregullës 01/2023 Për Regjistrimin dhe Funksonimin e Partive Politike.
- III. Partia politike Srpska Demokratija, obligohet që brenda gjashtë (6) muajve nga data e regjistrimit të mbajë Kuvendin në bazë nenit 12 të Rregullës 01/2023 Për Regjistrimin dhe Funksonimin e Partive Politike.
- IV. Obligohet Zyra për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike që të përgatisë certifikatën e regjistrimit dhe ta regjistrojë partinë politike Srpska Demokratija në Regjistrin e Partive Politike të Kosovës.
- V. Obligohet Zyra për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike që ta njoftoj partinë politike Srpska Demokratija, për marrjen e këtij Vendimi.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi me datën e nënshkrimit.

Prishtinë, 06.12.2023

Kryesues
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve



Kreshnik Radoniqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 59 dhe 63 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 06.12.2023, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Pjesëmarrjes së KOZ në punëtori në Tiranë

- I. Miratohet pjesëmarrja e KOZ në punëtori për Analizën Zgjedhore dhe 'Lessons Learned' të Zgjedhjeve Vendore të Majit 2023.
- II. Pjesëmarrës në këtë punëtori janë :
 - 1.Kreshnik Radoniqi
 - 2.Ibrahim Selmonaj
 - 3.Illir Gashi
- III. Obligohet Sekretariati i KOZ-së, për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 06.12.2023

Kryesues

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve


Kreshnik Radoniqi
Republika e Kosovës
Republika Kosova
Prishtinë
Priština
CENTRALNA IZBORNA KOMISIJA



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63 dhe 64.2 Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 06.12.2023, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Takimit të Punës për “Shqyrtimin e Rregulloreve të Brendshme të KQZ-së”

- I. Miratohet rekomandimi i Këshillit për Personel, për takimin e punës për “Shqyrtimin e Rregulloreve të Brendshme të KQZ-së”.
- II. Takimi do të mbahet më datën 18-20 dhjetor 2023, në Prishtinë.
- III. Shpenzimet për këtë takim pune do të mbulohen nga OSBE.
- IV. Obligohet Sekretariati për zbatimin e këtij vendimi.
- V. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 06.12.2023

Kryesues

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 10 të Ligjit Nr.03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37 paragrafi 2 nën paragrafi (c), të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 5 paragrafi 1.3, dhe nenin 7 të Udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, Nr.01/2017, si dhe Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, KI45/2020 dhe KI46/20, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 06.12.2023, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Z.Fidan Berisha**, emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Fushë Kosovë, nga subjekti politik "Lidhja Demokratike e Kosovës", duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal z.Remzi Shala.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet z.Fidan Berisha dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatim.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 01.12.2023, Nr.09/1/1222/2023, për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal z.Remzi Shala, i cili ka dhënë deklaratën e dorëheqjes, për arsye profesionale dhe personale.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar se, kandidati në listën e rirenditur është z.Fidan Berisha.

Kandidati i radhës ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit, nga i njëjti subjekt politik, me numër më të madh të votave, duke mos tejkaluar kuotën prej 30 % , të kufirit minimal të përfaqësimit gjinor të gjinisë pakicë, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2021.

Andaj, pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

Prishtinë 06.12.2023

**Kryesues
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**

Kreshnik Radonjqi





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 59.6 dhe 63 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 06.12.2023, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Autorizimin e Kryeshefit Ekzekutiv të SKQZ për Nënshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet KOZ dhe ASK

- I. Autorizohet Kryeshefi Ekzekutiv i SKQZ z.Burim Ahmetaj, për nënshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Agjencisë së Statistikave të Kosovës, për përdorim të 700 kuti të votimit 80 ltr.

- II. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 06.12.2023

Kryesues

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kreshnik Radonij